



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## KALLËZIMET PENALE PËR SUBJEKTET E VETTING-UT NGA VETË INSTITUCIONET E VETTING-UT


### Kallëzime pranë SPAK



Nisur nga rrethanat faktike të zbuluara gjatë procesit të hetimit administrativ të kryer nga KPK, janë depozituar 13 kallëzime pranë SPAK.


Nga ana tjetër, konstatohet se KPA nuk ka depozituar asnjë kallëzim pranë SPAK.

### Vendimmarrja e KPK sipas funksioneve të subjekteve të rivlerësimit




Në periudhën Janar 2021-Tetor 2022, KPK ka dhënë 99 vendime shkarkimi, nga të cilët 52 kanë qënë gjyqtarë, 45 prokurorë dhe 2 inspektor, nga të cilët një inspektor i komanduar në ILD dhe 1 inspektor në KLGJ.

### Vendimarrja e KPA në lidhje me vendimet e KPK



Gjatë periudhës Janar 2021-Tetor 2022 KPA ka shpallur 79 Vendime. Në 57 raste është lënë në fuqi vendimi i dhënë nga shkalla e parë e vettingut (KPK), kurse në 18 raste KPA ka ndryshuar vendimin e KPK. Në vetëm 4 raste, KPA ka vendosur prishjen e vendimit të KPK.

### Subjekte të rivlerësimit që kanë dhënë dorëheqjen



Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga KPK rezulton se gjatë periudhës Janar 2021 - Tetor 2022, 41 subjekte janë dorëhequr, në zbatim të nenit 56 të ligjit nr. 84/2016. Kjo kategori përbëhet nga 24 gjyqtarë, 10 prokurorë, 1 ish-prokuror, 5 ndihmës ligjor dhe 1 këshilltar ligjor në Gjykatën Kushtetuese

